

PARAQITJA E LIBRIT TË CARMEN HERNÁNDEZ “DITARËT 1979-1981”

Kard. Christoph Schönborn

Kiko Argüello

Costanza Miriano

Auditori i CEI

Rruga Aurelia 796 – Romë

15 nëntor 2017

Shënime të nxjerra nga regjistrimi

PARAQITJA E LIBRIT TË CARMEN HERNÁNDEZ “DITARËT 1979-1981”

– Lutja e fillimit: Kardinali Christoph Schönborn

– Hyrje:

Cantagalli:

Falënderoj me gjithë zemër Shkëlqesinë e Tij, Kardinalin Christoph Schönborn, Arqipeshkvin e Vjenës, znj. Costanza Miriano dhe Kiko Argüello-n që pranuan ftesën e shtëpisë botuese Cantagalli për të marrë pjesë në paraqitjen e vëllimit të Carmen Hernández Barrera me titullin “Diari 1979–1981”.

Atyre u shkon gjithë mirënjohja dhe falënderimi im.

Pak muaj më parë pata rastin të lexoja një përkthim të parë të ditarëve të Carmen-it, ende për t’u përpunuar, që ma dha miku don Ezechiele Pasotti, i cili më pyeti nëse isha i interesuar ta botoja këtë vepër. Duke lexuar shënimet e shkruara nga Carmen-i, ndieja një ndjesi të çuditshme në zemër. Megjithatë, mendja ime nuk arrinte ta deshifronte atë përshtypje, e cila nuk ishte as e re dhe as e panjohur. Edhe herë të tjera e kisha provuar atë ndjenjë, e cila më pas i linte vend qetësisë dhe ëmbëlsisë. Duke reflektuar mbi këtë, më rikthehej vazhdimisht në mendje një fjali që Carmen-i e

përsërit në Ditarët e saj: «Jezu im, të dua, të dua. Eja, eja, më ndihmo», sikur dikush të më sugjeronte me delikatesë se pikërisht aty gjendej çelësi për të kuptuar atë emocion, të njohur, por njëkohësisht të pakapshëm.

Falë asaj fjalie arrita më në fund ta zgjidhja këtë dilemë të vogël dhe ndjeva për Carmen-in, të cilën nuk e kam njohur e as takuar kurrë, një ëmbëlsi të madhe dhe një dashuri të madhe.

Me atë fjali, në të vërtetë, Carmen-i vinte në pah një aspekt thellësisht njerëzor që karakterizon fenë dhe marrëdhënien e njeriut me Hyjin.

Nostalgjia për praninë e vazhdueshme të Krishtit në jetën tonë, nevoja për ta përqafuar, për të folur ballë për ballë me Të, për të soditur Fytyrën e Tij, për të ndarë me Të gëzimet dhe ankthin tonë, ashtu siç mund të bëhet me një baba ose me një nënë, me një mik ose me personin e dashur. Po, sepse, të dashur miq, për këtë ka nevojë një burrë dhe një grua në jetë, dhe kjo e karakterizon fenë e krishterë nga të gjitha fetë e tjera. Në krishterim ka ndodhur një ngjarje unike, e cila deri në lindjen e Krishtit konsiderohej e pamundur; Hyji bëhet njeri, u tregon njerëzve Fytyrën e Tij, mishin e Tij, duke ndërprerë një traditë sipas së cilës askush nuk mund ta shihte ose të fliste me Hyjin.

Hyji zbulon Fytyrën e Tij dhe kështu përqafon njerëzimin, duke u bërë i gatshëm fizikisht për t'u dashur dhe për t'u kuptuar.

Reciton poeti Mario Luzi:

*E kujt është mungesa e kësaj mungese,
zemër,
që papritur je mbushur me të?*

Mungesa qëndron në pamundësinë njerëzore për ta përqafuar Krishtin, për të ndarë me Të një çast të jetës sonë, edhe pse, megjithatë, duke matur praninë e Tij dhe dashurinë e Tij të pafund.

Mendoni vuajtjen e thellë të Carmen-it dhe dëshirën e saj për të përqafuar një atë që e do dhe që ajo e do mbi çdo gjë tjetër, që i flet, që e ngushëllon, që shfaq praninë e tij, por që megjithatë nuk mund të përqafohet dhe të përkëdhelet në mënyrë konkrete. E kujt është mungesa e kësaj mungese, zemër, që papritur je mbushur me të?

E kujt është mungesa e kësaj mungese që sot pushton zemrën e njeriut bashkëkohor, ku Hyji është bërë një entitet abstrakt, teorik, ku duket se vetë natyra e Tij është tretur në vorbullën e së përkohshmes, të emocionalitetit dhe të nihilizmit. Hyjin askush nuk e njeh dhe askush nuk mund ta shohë... lexoni me vëmendje fjalët e Carmen-it dhe

braktisuni në një përvojë dashurie që do ta mbushë zemrën dhe do t'jua ndryshojë përgjithmonë jetën.

Tani ia kaloj fjalën Shkëlqesisë së Tij, Kardinalit Christoph Schönborn. Faleminderit.

Kardinali Christoph Schönborn OP:

Të dashur vëllezër dhe motra! Të dashur bashkëvëllezër Ipeshkvij, meshtarë, diakonë, i dashur Kiko, i dashur Atë Mario, të dashur miq të Carmen-it!

Përpara nesh kemi një pjesë të vogël të Ditarit të Carmen-it: vitet 1979-1981. Të gjitha vitet e mëparshme dhe të mëvonshme, që nga fillimi i Ecjes Neokatekumenale deri në vdekjen e Carmen-it, më 19 korrik 2016, janë ende të pabotuara.

Por a mundet, a është e lejueshme, të botohet një ditar kaq personal? Me këtë pyetje të vështirë filloj këtë përpjekje për të paraqitur këtë fragment të vogël, të botuar tani, të një thesari me sa duket shumë më të gjerë shënimesh krejtësisht personale të Carmen-it.

Ka lloje shumë të ndryshme ditarësh. Disa shkrimtarë kanë mbajtur një ditar me qëllimin që, më vonë, të botonin shënimet e tyre. Julien Green ka botuar vetë pjesët e ndryshme të ditarit të tij. Reflektimet e tij personale ishin që në fillim të destinuara për një publik të gjerë. Ato janë një lloj autobiografie me pjesë të vazhdueshme. Shën Augustini, me “Rrëfimet” e tij, ka krijuar diçka unike, të re: ai shkruan jetën e tij në formën e një kënge të vetme dhe të gjatë lavdërimi, të një lutjeje të madhe falënderimi ndaj Hyjit. Ai rrëfen veprat e mëdha të Hyjit në jetën e tij, në krijimin dhe në veprën e shëlbimit. Por Augustini synonte që këto “rrëfime” të tij t’i bënte të njohura, sa më shumë që të ishte e mundur, për shumë njerëz. Dhe me të vërtetë këto “*Confessiones*” të tij janë bërë libri i tij më i famshëm.

E ndryshme është situata e “*Diario Espiritual* (Ditari Shpirtëror)” të Shën Injacit të Loyolës. Pas kthimit të tij, Injaci mbajti një ditar shpirtëror. Arsyet ishin dy: mirënjohja ndaj Hyjit dhe vigjilenca e ndërgjegjes. “Injaci i konsideroi reflektimet e tij mbi hiret e marra [nga Hyji] para së gjithash si shprehje të mirënjohjes personale” (*Ignatius von Loyola, Il diario spirituale*, nën kujdesin e A. Haas SJ dhe P. Knauer, Freiburg 1961, f. 79). Injaci dëshiron të kujtojë vazhdimisht të gjitha hiret e marra nga Hyji. Ai dëshironte t’i mbante gjithmonë në kujtesë dhe, për këtë arsye, kthehej shpesh për të rilexuar shënimet e tij të mëparshme. “Në këtë mënyrë, në zemrën e tij ringjallej shpesh ai zjarr mistik i përvojave të kaluara” (po aty, f. 80). Por ditarët e tij i shërbenin gjithashtu edhe për një shqyrtim të matur të ndërgjegjes, për dallimin e shpirttrave. Ditari i tij duhej ta ndihmonte të konsideronte, në një mënyrë gjithnjë e më të kujdesshme dhe të ndjeshme, udhëheqjen e Hyjit, duke ushtruar artin e dallimit.

Kështu, ditari i tij ishte për të një mjet i rëndësishëm për t'u lënë të udhëhiqej më mirë nga Hyji.

Për Injacin, Ditari i tij ishte diçka jashtëzakonisht personale, jo e destinuar për publikun. Bëhej fjalë për një dialog ndërmjet tij dhe Hyjit. Për këtë arsye, vetë Shën Injaci, nga fundi i jetës së tij, shkatërroi një pjesë të madhe të ditarëve të tij. Një pjesë e vogël e tyre u gjet pas vdekjes së tij, në tryezën e tij të punës (krh. po aty, f. 82 e vijim). Bëhet fjalë për shënime të vetëm një viti, nga 2 shkurti 1544 deri më 27 shkurt 1545.

Përse flas për të gjitha këto? Sepse më prek pyetja nëse është e drejtë të depërtosh në shënimet intime që dikush i ka shkruar për t'i dhënë vetes arsye, në një mënyrë krejtësisht personale, për ecjen e tij me Hyjin. Besoj se kjo pyetje na ndihmon gjithashtu për ta lexuar në mënyrën e duhur Ditarin e Carmen-it dhe për të nxjerrë prej tij një dobi shpirtërore.

Përpara se të vij te të folurit për Ditarin e saj, do të doja të përmend shkurtimisht tri lloje të tjera shënimesh personale, të cilat mund të jenë të dobishme për t'i vendosur ditarët e Carmen-it në kontekstin e duhur.

1. Papa i Shenjtë Gjon XXIII. “*Giornale dell'anima* (Ditari i shpirtit)” i tij u bë i famshëm në të gjithë botën. Që kur ishte 14 vjeç, ai shkruante shënime shpirtërore, duke vazhduar për gati 70 vjet, deri pak kohë përpara vdekjes së tij. Vetë ai i quajti këto shënime “ditari i shpirtit” të tij dhe ia dorëzoi vetë sekretarit të tij Loris Capovilla, me lejen që këto shkrime të botoheshin pas vdekjes së tij: “Mund t'u ndihmojnë shpirttrave që ndihen të thirrur drejt meshtarisë ose drejt një bashkimi më të thellë me Hyjin”. Ne i jemi mirënjohës Papës së mirë Gjon, që vendosi kështu!

2. Ndryshe është rasti i Papës tjetër të Shenjtë të kohëve tona, i shenjtëruar së bashku me Papën Gjon nga Papa Françesku: Papa Gjon Pali II. Shënimet e tij personale përfshijnë më shumë se dyzet vjet të episkopatit të tij, që nga koha kur ishte Ipeshkëv ndihmës i Krakovit e deri dy vjet para vdekjes së tij. Në testamentin e tij, Papa Gjon Pali II kishte vendosur qartë: “Shkrimet personale duhen djegur”. Sekretari i tij personal për shumë vite, Stanisław Dziwisz, shkruan natyrisht: “Nuk pata guximin t'i digjja fletët dhe fletoret me shënimet personale që ai kishte lënë, sepse ato përmbajnë informacione të rëndësishme mbi jetën e tij... Ato janë një çelës për të kuptuar përshtypjet e tij, domethënë atë që përbën thelbin e brendshëm të një personi: marrëdhënien e tij me Hyjin, me njerëzit e tjerë dhe me veten e tij”.

3. Së fundi, një fjalë për Shën Terezën e Kalkutës. Nënë Tereza ka luftuar gjatë që të digjeshin shkrimet e saj personale, veçanërisht letrat në të cilat ajo hapte shpirtin e

saj. Ajo nuk dëshironte që jeta më intime e shpirtit të saj t'i zbulohej publikut. Pothuajse askush nuk e parashikonte se Nënë Tereza kishte vuajtur për dekada nga një errësirë e thellë e brendshme, se ajo jetonte në një gjendje të vazhdueshme “nate të errët”, ndërsa nga jashtë të gjithë e shihnin si Nënë Terezën e mirë, të gjallë dhe plot dritë. Vetëm përmes botimit të shumë prej letrave të saj plotësisht personale drejtuar etërve të saj shpirtërorë u bë e ditur se Shenjtorja përjetonte në brendësinë e saj një shkretëtirë shpirtërore jashtëzakonisht të thellë. Ky ishte realiteti i saj më i fshehtë. Nga kjo pjesëmarrje në agoninë e Krishtit buronte bollëku i fryteve të veprës së saj. Ky ishte burimi i fshehur i frytshmërisë së saj.

Shpresoj të më falni për këtë hyrje të gjatë në Ditarin e Carmen-it. Por besoj se është e dobishme të shohim kontekstin më të gjerë në të cilin ai vendoset. Dhe është e rëndësishme të jemi të vetëdijshtë për faktin se nuk është e vetëkuptueshme që të mund të shohim kaq thellë në shpirtin e një personi. Leximi i një “*Ditari të shpirtit*” është diçka e ndryshme nga leximi i një autobiografie. Në një farë mënyre, këtu hyhet në një “tokë të shenjtë” dhe duhet të hiqen këpucët, sepse këtu gjendet “kaçuba e ndezur” e pranisë së shenjtë të Hyjit (krh. Dal 3,5).

Ditarët e Carmen-it natyrisht që nuk ishin menduar për botim. Bëhet fjalë për tekste të shkurtra, shënime, thirrje, klithma për ndihmë, lutje. Rrallëherë kemi fjali më të gjata. Rrallëherë kemi trajtime më të zgjeruara. Nuk bëhet fjalë për traktate teologjike, për reflektime të përgjithshme. Shënimet e shkurtra janë plotësisht personale, kryesisht thirrje, lutje të shkurtra dhe tregues të gjendjeve të shpirtit.

Dy aspekte më bien më shumë në sy: “Të dua, Jezus; Jezusi im!” dhe fjalët rrëqethëse mbi trishtimin e saj të brendshëm, mbi errësirën, mbi përvojën e asgjësë së saj, të paaftësisë së plotë, të natës: “Dhe është natë. Fantazma vdekjeprurëse. Natë e tmerrshme. Ngrihen fantazma që më konsumojnë në pafuqinë, në fajin, në dhimbjen. Jezusi im, sikur unë të isha fajtorë për gjithçka. Ty të thërras në natë... pa përgjigje. Agimi, përse? Jezusi im, konsumoj veten në trishtim, në hiçgjë. Jezus, po vdes duke të pritur Ty. Jeta!” (11 prill 1980) (239).

Çfarë lufte! Sa vuajtje e brendshme! Dhe drita gjithmonë kthehet të shkëlqejë në errësirë, dhe paqja e mbush zemrën e saj: të nesërmen Carmen-i shënon, pasi citon Zbulesën: “Do të luftoj kundër fantazmave të errësirës. Të mos dialogoj me to, të mos lejoj të më kapin nga fija. Largohu, Satan. Zoti i ringjallur... Gëzomë, o Zot, lufto në krahun tim, jep forcë, jetë eshtrave të mi. Eja, o Zot” (12-13 prill 1980) (240).

Dhe ditën pasuese: “Faleminderit, o Zot, sepse më ngre nga gropa. Zhduken fantazmat, nata, trishtimi, frikat, tmerri. Jezusi im. ‘Paqja’, liria, dashuria. Gjithçka ndryshon në mënyrë të pabesueshme, pa ndryshuar asgjë jashtë. Gjithçka është mister në zemër, Jezusi im, ku vetëm Ti arrin. Faleminderit, o Zot, që më nxit të lutem. Aq shumë për të bërë... të lutem, një program për nesër. Më ngri përsëri.” Dhe pastaj gëzimi i Pashkës: “Jezusi im, sytë të ngulur te Ti. Tashmë pothuajse më hidhet shpirti nga gëzimi. Ah, sikur të mund t’i varrosja këtu fantazmat. Më udhëhiq, me sytë të ngulur te Ti, duke luftuar, pa të ardhme dhe as të shkuar, me sytë të ngulur në të tashmen. Ti je e tashmja. Rrobat e tua, aloe dhe mirrë (Ps 45,9), Jezus shumë i ëmbël, çlirimtar” (14 prill 1980) (241).

Pothuajse në çdo shënim të përditshëm, Carmen-i flet për mjerimin e saj të brendshëm. Mendimi shkon te ajo që kanë zbuluar shënimet personale të Shën Nënë Terezës së Kalkutës. Disa tekste janë mbresëlënëse. Mjerimi i thellë shpirtëror, nga i cili me sa duket Carmen-i ka vuajtur gjatë gjithë atyre viteve. Që në shënimin e parë të Ditarit shfaqet e gjithë thellësia e kësaj vuajtjeje:

“Kur gjithçka zhduket në asgjë dhe nata në errësirë, shpirti ushqehet me asgjënë. O Zot, ku? Si? Kush je Ti? Ti je një Hyj misterioz, i fshehur, dhe mungesa jote e bën të pamundur gëzimin. Dhimbja ma ha jetën, vret çdo mundësi dhe akuzon çdo të tashme. Akuzues i pamëshirshëm, i tmerrshëm, shkatërrues.”

“Jezus, Jezusi im, Ty të thërras natë e ditë. Eja, eja, Dashuria e rinisë sime dhe e shpresës sime. Mbushmë me forcë, sepse po fundosem në asgjë. Eja, Jezus. Të dua. Shpresoj vetëm në Ty. Ki mëshirë për pafuqinë time të plotë, për asgjënë time rrënjësore. Eja, eja, Ti. Ti je e Vërteta, i Vetmi. Ti ekziston” (13 janar 1979).

Nëse pothuajse në të gjitha shënimet e përditshme del në pah varfëria e saj shpirtërore, kjo ndodh gjithmonë së bashku me besimin dhe dashurinë e saj për Jezusin. Fjalët e saj të vajtimit kalojnë, pa ndërprerje, nga “nga humnera të thërras” (Ps 129) te shpallja e dashurisë për Jezusin, shprehje e besimit të saj të plotë tek Ai.

Frika nga katekezat: “Nesër katekeza... paaftësi e plotë... pafuqi e tmerrshme... Jezus, jam pa fjalë, nuk kam as edhe një ide në kokë. Si mund të dalin fjalët? Unë nuk di të flas. Eja, Shpirti Shenjtë” (5). Të nesërmen: “Unë nuk di të flas. Jam e tmerruar, e përndjekur, e akuzuar, e shkatërruar, e vdekur. O Zot, eja. Ndriço paaftësinë time, errësirat e mia, tmerret e mia. Eja, o Zot” (6). Por gjithmonë, pas katekezave, rikthehen gëzimi, paqja dhe mirënjohja: “Natë, pas katekezës. Faleminderit, o Zot. Ndihem e rilindur, e ripërtërirë, e shëruar. Më ndihmo. Mua më ka shërbyer për t’u ringjallur, për të jetuar. Faleminderit, Jezus. Jam e lumtur. Hapi buzët e mia. Më ndihmo të vazhdoj. Mos më lër në gjysmëhije dhe në vdekjen e shterpësisë sime. Më ndihmo të mund të të dua. Eja, Jezus” (6).

Çaste gëzimi të thellë, paqeje, dhe pak më pas përsëri një dëshpërim i thellë: “Si është e mundur të kalosh nga gëzimi i natës së djeshme në ankthin e zgjimit? Jeta më bie përsipër. Gjithçka bie si një turp, si një akuzë pesimizmi dhe mohimi. O Zot, ngrihu, eja i ndritshëm në ringjalljen Tënde... Po tremem në pritje. Shpresoj në Fjalën Tënde. Shikoj sytë e mi, Ti i pari. Ty të thërras, o Zot. Dëgjoje britmën time të tmerrit dhe të trazimit. Ruaje jetën time” (8).

Një herë Carmen-i shkruan: “Që kur jam e lumtur nuk di çfarë të shkruaj...” (54). Pothuajse do të tundohesha të thoja: faleminderit, Carmen, që megjithatë ke shkruar! Faleminderit që na ke lejuar të shohim sadopak zemrën tënde!

Faleminderit që na ke treguar luftërat e tua të brendshme dhe të jashtme. Për shembull, atë me cigaret! “O Zot, më ndihmo të mos pi dy paketa cigare” (17, krh. 3, 207, 220, 231, 658). Ajo ankohet për “vetëm duke pirë cigare e duke pirë cigare në mënyrë të varur, marrëzisht” (185).

Faleminderit për fjalët e tua për Kiko-n, për mirënjohjen tënde dhe për lutjen tënde për të. Shpesh ajo i lutet Jezusit kështu: “Ndihmoje Kiko-n. Forcoje. Shenjtëria jote zbrihtë mbi ne” (59). Dhe e falënderon Jezusin: “Shoh se Ti e frymëzon Kiko-n. Ndihmoje. Faleminderit, Jezus” (69). Ajo është thjesht mirënjohëse për Kiko-n: “Më ngushëllon ta shoh Kiko-n mirë këtu. Është e pabesueshme qëndrueshmëria e tij” (57). Ajo e falënderon Jezusin për karizmën e Kiko-s dhe e sheh se karizma e saj nuk është e njëjtë me të tijën: “Më mahnit guximi që i jep Kiko-s. Po t’i ndodhte atij ajo që më ndodh mua, do të ishte katastrofike” (185). Por nuk do të ishte Carmen-i, nëse herë pas here nuk do të shkruante atë që shumë veta e kanë dëgjuar edhe publikisht: “Kiko i padurueshëm” (657). “Jezusi im, ky Kiko gjithë ditën në veprim. Unë do të doja të ulesha me Ty në paqe, me librat, me Ty. Jezusi im, aq shumë gjëra me nxitim. Jezusi im, gjithçka kalon shpejt. Më çliro!” (766). Dhe diku tjetër: “Kiko gjithmonë si një tërmet që të çrrënjos nga rehatia.” Por në të njëjtin shënim të ditarit, Carmen-i thotë për veten: “Jam unë, një përbindësh i tmerrshëm” (645).

Është tashmë një nga ngjarjet më të jashtëzakonshme në historinë e Kishës së kohës sonë që Hyji bashkoi dy njerëz kaq të ndryshëm në një mision kaq thellësisht të përbashkët. Ditarët e Carmen-it, së bashku me “Shënimet 1988-2014” të Kikos, do të na ndihmojnë të kuptojmë më thellë se si është rritur Ecja Neokatekumenale, çfarë e ka frymëzuar dhe si ka mundur të bëhet, nga një kokërr e vogël sinapi, një pemë kaq e madhe!

Sigurisht që në Ditarin e Carmen-it do të ketë ende shumë gjëra për t’u zbuluar. Jo vetëm mbi jetën e saj të brendshme, mbi luftërat e saj, mbi dashurinë e saj të pakushtëzuar për Jezusin, por edhe shumë mbi zhvillimin e Ecjes Neokatekumenale. Do të jetë e rëndësishme të nxirren në pah, nga ky ditar, perlat e veçanta. Për shembull, kur shkruan më 21 shkurt 1979: “Ora tetë e mëngjesit. Ende pa fjetur. Jezus, Ti je befasues. Sa ide të mrekullueshme. Shoh se si të përfundohet

Katekumenati dhe papritur shoh gjithçka të ndriçuar dhe një të ardhme, pak nga pak.”
Më pas vijojnë ide për përfundimin e Ecjes, të cilat ndërkohë, për shumë bashkësi,
janë bërë realitet.

Veçanërisht prekëse janë shprehjet dhe meditimet për Natën e Pashkës, për Vigjiljen
e Pashkëve. Në fjalët e Carmen-it për Natën e Pashkës ndihet një gëzim kaq i madh!
Këtu ka vërtet frymëzim, veprimin e Shpirtit Shenjtë: “Pashka më mbush me gëzim,
si një ndriçim i fuqishëm në mes të natës. O Zot, Ti je i madh. Të dua. Faleminderit,
Jezus” (1 prill 1979) (73).

Shpesh hasen fragmente që ajo i titullon “Ide” (për shembull nr. 131-133, 136). Janë
elemente për Katekezat, skica të asaj që për Carmen-in është e rëndësishme, të asaj
që ajo dëshiron të thotë. Rikthehet shpesh Konkili II i Vatikanit! Realizimi i asaj që
Shpirti Shenjtë dëshiron t’i thotë sot Nuses, Kishës.

Më prekin në mënyrë të veçantë fjalët që Carmen-i thotë kur flet për Popullin e Hyjit.
Është realizimi i vizionit të Konkilit. Ajo sheh atë që ka thënë Konkili. Me rastin e
kremtimit të Natës së Pashkës të vitit 1979 shkruan: “Shoh një popull që ecën drejt
Lirisë, atje ku Pashka po e udhëheq. Jezusi im, sa i lumtur jam” (68).

Një popull që ecën drejt Lirisë! A nuk është ky vizioni i madh i Konkilit? Në
dashurinë e saj për Jezusin, në përkushtimin e saj, në *kenosin* (zbritjen) e saj (68), në
pasionin e saj, Carmen-i ka kontribuar me siguri në mënyrë vendimtare që sot, në
mbarë botën, një popull të ecë drejt Lirisë. Jezusi iu përgjigj dashurisë së saj dhe ajo
u bë frytdhënëse. Ajo ua hapi shumë njerëzve rrugën drejt lirisë, rrugën drejt Jezusit.
Si të mos jemi mirënjohës ndaj Hyjit për këtë dhuratë dhe mirënjohës ndaj Carmen-it
që tha “Po”-në e saj?

Faleminderit!

Davide Cantagalli:

Në portretin që Shkëlqesia e Tij bëri për Carmen-in, unë përjetova atë ndjesi për të cilën fola më parë, atë ndjenjë të madhe dhembshurie dhe dashurie për një person që, për fat të keq, nuk e kam njohur. Por ky portret që Kardinali ka bërë, duke lexuar pjesë nga shkrimet e Carmen-it, është kaq i thellë, kaq depërtues dhe kaq familjar, sa të duket pothuajse, siç thashë, se mund ta përqafosh, se mund të flasësh me të, se mund ta jetosh dramën e fesë; e cila, siç thashë, nuk është një përvojë emocionale kalimtare, por një përvojë konkrete. Faleminderit.

Tani ia kaloj fjalën znj. Costanza Miriano.

Costanza Miriano:

Unë jam përpjekur ta shmang këtë nder, sepse edhe unë, ashtu si moderatori, nuk e pata gëzimin ta njihja Carmen-in. Dhe e di mirë se mes jush ka njerëz që do ta meritonin shumë më tepër se unë të ishin këtu në vendin tim. I telefonova Kiko-s dhe ai më tha disa gjëra në spanjisht që nuk i kuptova. Por në fund tha: «¡Ánimo!». Atëherë e kuptova se, kur ai thotë kështu, nuk ka vend për diskutim. Prandaj jam këtu.

Atëherë u përpoqa ta zbuloja këtë fytyrë të Carmen-it, mbi të gjitha duke lexuar, por edhe duke parë disa video të saj që gjeta. Por edhe më parë, ata që më kanë folur më shumë për të kanë qenë pa dyshim gratë e Ecjes, disa prej të cilave i njoh personalisht dhe i kam shumë mike. Janë gra të formuara në urtinë e Carmen-it dhe që kanë përvetësuar antropologjinë e saj, vizionin e saj për burrin dhe gruan. Janë gra me karakter të fortë – nuk e di nëse mund ta them këtë në praninë e Kardinalit –, shumë burrërore, siç do të thoshte Tereza e Avilës, të pajisura me një frytshmëri të madhe, jo vetëm fizike, por edhe shpirtërore. Janë gra që kanë guximin t'i kundërvihen katekizimit të botës mbi gruan.

Në fakt, edhe përpara se ta lexoja këtë ditar dhe të mësoja diçka më shumë për Carmen-in, pyesja veten nëse nuk ishte një grua pas gjithë kësaj pasurie dhe kësaj frytshmërie. U përpoqa të kuptoja diçka prej saj. Edhe unë mbeta, siç besoj se u ndodh të gjithëve që u afrohen këtyre faqeve, e prekur nga kjo botë e brendshme kaq e vuajtur, kaq e mundimshme, kaq e rëndë. Mbeta gjithashtu e habitur nga fakti se të gjithë ata që e kishin njohur nuk kishin për idenë e një mundimi kaq të madh të brendshëm.

Mendoj se në të vërtetë shumë gra përpiqen ta bëjnë këtë punë të brendshme mbi veten, pa e shfaqur gjithë lodhjen dhe gjithë vuajtjen që kjo sjell. Nëse do ta pyesni

burrin tim, ndoshta ai do t'ju thotë se unë nuk e bëj këtë përpjekje për t'u përmbajtur. Por unë mendoj se ankohe shumë pak në krahasim me sa do të doja, edhe pse ai, përkundrazi, thotë se unë bëj vetëm këtë. Ishte bukur të njihja edhe tek ajo atë që ka qenë për mua – dhe edhe për shumë gra që njoh – atë që unë e quaj “humnera”, kjo zbrazëti e brendshme, kjo nevojë, që në të vërtetë është hapësira jetike, kjo zbrazëti që ka gruaja, që është nevoja për t'u parë, për t'u pranuar, për t'u përqaftuar, për t'u dashur. Dhe kjo është një humnerë që askush, përveç Krishtit, nuk arrin ta mbushë.

Carmen-i ka ditur t'i japë një emër shqetësimit të saj. Siç tha Kardinali, nuk ka asnjë shënim në ditar, nuk ka asnjë ditë, në të cilën ajo të mos e thërrasë Jezusin, të mos e ftojë dhe t'i përgjërohet të vijë. Prandaj ajo e ka mbajtur gjithmonë shikimin të ngulur në vendin e duhur.

Besoj se ky është një libër i çmuar, sepse në të vërtetë këtë humnerë e kemi të gjitha, edhe pse ka nga ato që e dëgjojnë më shumë dhe nga ato që e dëgjojnë më pak; ka nga ato që janë më të stërvitura t'i japin emrin e duhur dhe nga ato që, përkundrazi, shpërqendrohen. Dhe bota luan shumë me këtë nevojë femërore për t'u njohur e për t'u pranuar. Djalli vepron mbi ne gratë, sepse ne, siç thoshte gjithmonë Carmen-i, mbajmë në vetvete matricën e jetës. Prandaj, kur goditet një grua, të gjithë ata që i janë besuar, si në një efekt dominoje, bien bashkë me të. Kjo zbrazëti që kanë të gjitha gratë – edhe pse jo të gjitha, madje shumë pak, dinë t'i japin emrin e duhur – është mungesa e Jezusit, i Vetmi që mund ta mbushë këtë zbrazëti. Me anë të feminizmit dhe të katekezave njerëzore, tentohet që kjo zbrazëti të mbushet me mesazhin: “Kërko veten, afirmohu, mos u var nga askush”, duke na ftuar drejt *empowerment* (fuqizimit personal), që në mënyrë hysterike bërtet për diskriminimin dhe nxit marrjen e një qëndrimi viktimizues. Sepse loja e djallit është pikërisht të na pengojë ta takojmë Jezusin, të Vetmin që mund ta përmbushë këtë dëshirë, këtë pritje, këtë shikim që ne e dëshirojmë.

Dhe nëse kjo është e vërtetë për të gjithë, burra dhe gra, sepse shpirti është gjithmonë femëror, është veçanërisht e vërtetë për gratë, të cilat janë të përbëra nga kjo nevojë. Mitra, zbrazëti, aftësia për t'i bërë vend tjetrit dhe për të dhënë jetën, janë ana tjetër e kësaj nevoje, e kësaj dëshire. Ta shohësh këtë nevojë të shprehur me kaq sinqeritet, madje edhe me kaq ndershmëri ndaj vetvetes, ishte vërtet prekëse. Për më tepër, meqenëse nga frytet nuk kam asnjë dyshim se Carmen-i është një shenjtore (pema njihet nga frytet), është bukur të shohësh se edhe një njeri kaq pranë Hyjit lufton, bën betejën e tij të përditshme kundër të metave të veta, të cilat ajo i rendit me siguri me më shumë ashpërsi se të gjithë ata që jetonin pranë saj: flet për varësinë nga duhani, koprracinë, përtacinë, lodhjen. Nganjëherë edhe për vështirësitë me Kiko-n, megjithëse për të flet gjithmonë me shumë dashuri. Kjo është ngushëlluese, sepse zakonisht jetët e shenjtërve, sidomos kur tregohen nga të tjerët, na i paraqesin si të paarritshme, shumë larg mundësive tona.

M'u duk sikur dëgjoja Shën Palin në Letrën drejtuar Romakëve, kur shkruan: «E shoh të mirën, por nuk arrij ta bëj». Kjo është lufta e përditshme që bëjmë të gjithë. Pastaj përfundimi është: «Më çon në asgjë, që pastaj të më vendosë në lutje». Shoh se ndryshimi ndërmjet Carmen-it dhe meje, e ndoshta edhe shumë të tjerëve, është se ajo di ku ta vendosë këtë mungesë të saj, këtë dëshirë të saj, këtë zbrazëti që zemra kërkon të jetë e mbushur.

Më ka pëlqyer shumë edhe liria dhe vërtetësia e saj. Më është dukur se ajo, e cila nuk ishte rregulltare, madje thotë se shumë gjëra i duken bigote; nuk është një njeri që kërkon me Hyjin një marrëdhënie fetare në kuptimin formal, por një marrëdhënie feje, pra një marrëdhënie të vërtetë, të një nuseje me Dhëndrin. Është një liri e vërtetë në lidhje me fenë. Prandaj e bekoj këtë vuajtje të fshehtë dhe të heshtur të Carmen-it dhe unë e falënderoj që e pranoi dhe e mbarti me kaq besnikëri ndaj Kishës. Edhe ndaj Ecjes, por gjithmonë në këndvështrimin e Kishës. Sepse ajo e përsërit vazhdimisht se Ecja është e Kishës; e saja është një dashuri e plotë dhe e pakushtëzuar ndaj Kishës dhe ndaj Papës. Kam parë një libër ku ajo shpreh një dashuri të plotë dhe të pakushtëzuar për Papën, edhe kur ai është i keq, sepse Jezusi “ka bërë kompromis” me Pjetrin. Edhe pse në spanjisht kjo fjalë ka një kuptim tjetër, të barasvlershëm me “është angazhuar”, është i bukur edhe kuptimi italian i fjalës “*compromesso*” (ka bërë kompromis): lufton në krah të tij.

Po thosha se e bekoj këtë vuajtje të Carmen-it, këtë këmbëngulje të saj për të mos u lodhur kurrë duke kërkuar Dhëndrin, sepse besoj se pikërisht nga kjo mungesë lindi më pas sinteza që ajo e vuri në shërbim të Ecjes. Po të ishte kënaqur me një fe të vakët, me një fe bigote, nuk do t'i kishte dhënë vendin qendror që i dha Vigijljes së Pashkëve, lutjes, dashurisë për Fjalën e Hyjit, këtij kërkimi vërtetë jetik për Dikë, këtij kërkimi për Diçka prej së cilës varet me të vërtetë mbijetesa.

I jam mirënjohëse kësaj gruaje, të cilën më vjen keq që nuk pata mundësi ta njihja, por që, falë këtyre faqeve, e ndiej vërtetë si mike dhe si motër shumë më të madhe.

Faleminderit.

Davide Cantagalli:

Faleminderit, Costanza. Kur flisje për gruan që ka një ndjeshmëri të ndryshme dhe më të theksuar, më erdhi në mendje edhe një gjë tjetër: që gruaja është e favorizuar në fe, sepse përjeton diçka të ngjashme me fenë që nga momenti kur mban në bark fëmijën që do të lindë. Fëmija në bark, në njëfarë mënyre, është i paprekshëm, por nëna është e gatshme për gjithçka, për ta dashur atë me një dashuri të pafund që para lindjes. Për këtë arsye mendoj se gratë kanë një aftësi edhe më të madhe se burrat për të dialoguar me Hyjin, për të folur me Të, për të perceptuar praninë e Tij, për të

dalluar nga shenja të vogla faktin se Hyji na do dhe është i pranishëm në çdo çast të jetës sonë.

Tani do t'i kërkoja Kiko-s që ta përmbyllë këtë takim.

Kiko Arguello:

Falënderoj Kardinalin për pyetjen që bëri në fillim. A është e lejueshme t'i botojmë këto gjëra? A është e lejueshme? Carmen-i nuk do ta kishte pranuar kurrë!

Kjo është një pikë e parë. Kjo është një dhunë që i kam bërë Carmen-it për dashuri ndaj vëllezërve të Ecjes. Sepse për mua, siç mund ta imagjinoni, përballja me këto shkrime ka qenë një bombë, ose, nëse dëshironi, një goditje e tmerrshme në kokë. Sepse këto shkrime tregojnë pesëdhjetë vjet vuajtjeje të vazhdueshme. Por si është e mundur? Ajo thotë: "Jam e sëmurë?" Pa dyshim, nëse një psikiatër i lexon këto gjëra, thotë: "Këtu ka një depresion të tmerrshëm". Por ajo mua gjithmonë m'i ka fshehur këto gjëra; unë nuk dija asgjë për të gjitha këto, për këtë grua. Është e mahnitshme! Është e mahnitshme, por edhe emocionuese.

Lexoj këtu: "Takim i katekistëve në hotelin Wellington të Madridit: dhe unë e trishtuar, e trishtuar, e trishtuar. Gjithë ditën në një trishtim që më zhyt në asgjë, në pafuqinë absolute, në mosqenie. Çfarë dëshiron, o Zot? Nuk është e mundur që unë të jem e pranishme, indiferente ndaj gjithçkaje, ndërkohë që shpallet emri Yt! Më dëbo, o Zot. Ku? Për të bërë çfarë, o Zot? Asgjë nuk më intereson, asgjë. Të lëviz? Të pastroj? O Zot, pi cigare në mënyrë të varur, në këtë mungesë pranë nga vetja ime, duke u plakur në asgjë. Ki mëshirë për mua, Jezus! Të falënderoj për ditët kur më ke vizituar në gëzim. Eja, o Zot! Nesër shkojmë në Paris: asgjë nuk më intereson".

Kjo asgjë është absolute: asgjë nuk i intereson, as të jetë me mua, as bashkësitë; asgjë fare. Kjo është e vërteta! Duket sikur Hyji ka krijuar një lloj shkretëtire rreth saj, që ajo të ketë vetëm një gjë: dashurinë për Të. Etërit e shkretëtirës thonë: «Të duash Krishtin është e vetmja e vërtetë; gjithçka tjetër është kotësi». Ky është një pohim shumë i rëndësishëm. Unë ua them seminaristëve: «Mendoni se të duash Krishtin është e vetmja e vërtetë; gjithçka tjetër është kotësi». Shën Pali thotë: «Kush nuk e do Krishtin, qoftë i mallkuar!». Ekziston edhe një tjetër fjali e një Ati shumë të rëndësishëm të Kishës. Ai thotë: «Duaje Krishtin dhe mijëra do të të ndjekin». Nëse ti e do Krishtin, mijëra do të të ndjekin. Unë mendoja se, nëse shumë njerëz vinin në Ecje, ndoshta vinin për mua. Por sigurisht që nuk vijnë për mua. A e dua unë Krishtin ashtu siç e donte Carmen-i Krishtin? Absolutisht jo. Unë jam një mëkatar i varfër dhe asgjë më shumë. Megjithatë është e mahnitshme që Hyji më ka bashkuar me një grua kaq të jashtëzakonshme. Të gjesht një person që e do Krishtin kaq thellësisht, i aftë për ta jetuar çdo ditë trishtimin, asgjënë, vuajtjen më absolute. Në çastin e vdekjes i kërkoja Carmen-it: «Kush jam unë?» dhe ajo m'u përgjigj: «Një idiot!». Në fund e kuptova përse më thoshte këtë. Donte të thoshte: «Jam pranë teje dhe po vdes, ndërsa ti as nuk e kupton atë që kam brenda meje». Dhe kjo është e vërteta! Mund t'i

përgjigjesha: «Por pse nuk flisje? Mund të kërkoje ndihmë». Nëse unë e pyesja: «Carmen, si je?», ajo më përgjigjej: «Më lër të qetë».

Ato që kemi botuar janë vitet e para, në të cilat ajo flet për Ecjen dhe për katekezat. Por nëse do të lexonit vitet e fundit, çfarë tmerri! Nuk mund të lexohen. Me të vërtetë unë nuk mund t'i lexoj, sepse më dhemb. Pse nuk kërkoje ndihmë, pse nuk fole me mua? Nuk kishte nevojë të fliste me mua: unë isha një idiot.

Kam menduar se ju që bëni Ecjen keni të drejtë ta njihni shpirtin e Carmen-it, sepse ai është pjesë e formimit tuaj. Po ju lexoj letrën që më ka shkruar Papa:

Kiko Argüellos
Nismëtari i Ecjes
Neokatekumenale

Vatikan, 18 gusht 2017

Vëlla i dashur,
Kam marrë librin me *Ditarët* e shkruar nga Carmen-i gjatë viteve 1979-1981. Ju falënderoj për këtë dhuratë.

Më gëzon shumë fakti që, përmes këtyre faqeve, bëhet e prekshme dëshmia e një dashurie të madhe për Jezusin, drita e të Cilit e shndërron vuajtjen në dhurim, lodhjen në gëzim, jetën në një kohë për të ungjillëzuar.

Hyji e ndihmoftë Ecjen që në çdo çast të mbjellë Ungjillin me gëzim dhe pa rezerva, me fe dhe bindje të përvuajtur, duke i bërë provat dhe vështirësitë një arsye për t'u lavdëruar në Zotin Jezus.

Ju lutem, ju kërkoj të luteni për mua. Jezusi ju bekoftë dhe Virgjëra e Shenjtë ju ruajtë.

Me vëllazëri,
Françesku

Mund të bëjmë një duartrokitje.
Mirë! Unë kam shkruar një faqe të vogël.

Ju rekomandoj ta lexoni këtë libër, sepse bën një të mirë të jashtëzakonshme. Gjithmonë bën mirë të shohësh dashurinë e një personi për Krishtin. Sidomos sepse

ajo ka qenë katekistja juaj. Ka qenë së bashku me mua dhe me të tjerë, por mbi të gjitha së bashku me Shpirtin Shenjtë, ajo që ka lindur dhe ka ushqyer Ecjen Neokatekumenale, e cila është vërtet diçka e mahnitshme.

Tani vijmë nga Kina, ku kemi parë shumë mrekulli. Më parë ishim në Indi, në Bombai, me shumë vëllezër të gjithë entuziastë, të gjithë të lumtur, të gjithë donin të më preknin dhe të më puthnin. Në Kinë ishte e mrekullueshme të shihje meshtarët komunistë, të gjithë të dashuruar me Ecjen. Meshtarët komunistë janë ata të Kishës zyrtare. Unë pata një takim me ipeshkvën e Pekinit, i cili shtatë vjet më parë më tha: “Kina ka nevojë për një rikatekumenat”. Atëherë, pas shtatë vitesh, u ktheva për t’i thënë se ne jemi gati t’i sjellim Kinës rikatekumenatin. Po përgatisim 20.000 meshtarë për Kinën.

Sekretari i tij, i ipeshkvit, një kinez i gjatë, ishte entuziast. Por e dini përse ishte entuziast? Sepse kishte qenë në Domus. Dostojevski thotë se bukuria do ta shpëtojë botën. Këta kinezë mbetën të mahnitur nga bukuria e Domusit. Dhe tani janë të gjithë të lumtur me Ecjen Neokatekumenale. Na thanë: “Nesër fillojmë katekezat në katedralen e Pekinit”. Kalimi ynë ishte i mrekullueshëm: meshtarët ishin të gjithë entuziastë. Tre meshtarë, të cilët janë rrethi i afërt i Arqipeshkvit të Pekinit, të tre kanë qenë në Domus. Dhe tani u shfaqën entuziastë; vlerësojnë kitarat, katekezën, kerigmën, gjithçka. Në Kinë nuk kishin parë kurrë asgjë nga këto, nuk kishin dëgjuar kurrë diçka të tillë, ndërsa tani ishin të gjithë entuziastë. Kjo na ka ngushëlluar shumë. Jemi kthyer një javë më parë. Kemi parë dymbëdhjetë *missio ad gentes*, ku të gjitha familjet janë të lumtura. Kemi 57 bashkësi kineze. Kemi filluar gjithashtu edhe me Kishën klandestine. Kemi mbetur shumë të mahnitur.

Gjëja e parë që bëra kur shkova për herë të parë në Pekin, kërkova të më tregonin një vend të lartë nga ku të bëja një ekzorcizëm mbi qytetin. Shkuam në majë të një kulle televizive, së bashku me ekipin përgjegjës për Kinën. Kur arritëm në majë, fillova të godas kundër djallit: “Në emër të Jezusit të Nazaretit, largohu nga ky komb, të cilin e ke mashtruar me komunizmin, ku ke shkatërruar familjet, etj.” Në një moment Carmen-i më tha të ndaloja dhe të thërrisja Shpirtin Shenjtë. E thirra dhe menjëherë një pëllumb i bardhë u shfaq mbi ne.

Shkuam në Kinë sepse Kisha klandestine kishte njohur një motër të Ecjes Neokatekumenale, së cilës i kishte kërkuar t’u mësonte spanjisht disa seminaristëve që donte t’i dërgonte për të studiuar në Amerikën Latine. Për këtë arsye ajo iu drejtua një familjeje spanjolle të Ecjes në mision në Tajvan. Ne kemi një seminar në Tajvan dhe shumë bashkësi. Kjo motër u vu në dispozicion. Ajo tregon: “Më futën në një tren, me të cilin udhëtova për një kohë të gjatë. Pastaj më futën në një shtëpi dhe më vendosën në një dhomë të vogël. Në orën 5:30 të mëngjesit të ditës së nesërme më

zgjuan me një çaj. Pastaj hapa derën dhe përballë meje ishte një dhomë plot me kinezë, të gjithë të gjunjëzuar, që po lusnin rruzaren. Pak më vonë, ndërsa ata vazhdonin të qëndronin në gjunjë, hyri një meshtar që kremtoi meshën i kthyer nga muri. Pasi mbaroi mesha, një rruzare tjetër”. Ky ishte krishterimi në Kinë deri pak vite më parë në Kishën klandestine. Më pas kjo motër u çua përpara një dollapi. Kur u hap ai dollap, aty hyhej në një korridor, përmes të cilit hyhej në një shtëpi tjetër. Edhe në këtë shtëpi kishte një dollap tjetër, nga i cili hyhej në një korridor tjetër. Dhe kështu, nga shtëpia në shtëpi. Kisha klandestine përndiqet nga Partia komuniste: nëse i kapin, përfundojnë në burg.

Ndodhi që meshtarët përgjegjës të Kishës klandestine, të cilët përndiqen shumë, aq sa nuk mund të flenë disa ditë rresht në të njëjtin vend, duke folur me këtë motër dhe duke parë shpirtin e Ecjes, mbetën aq të tronditur saqë dëshiruan të flisnin me mua. Dhe ndodhi diçka e mrekullueshme: këta meshtarë, që kanë shumë bashkësi të fshehura, na i ofruan bashkësitë e tyre. E prekëm me dorë se midis nesh dhe atyre ishte i njëjti Shpirt, Shpirti Shenjtë. Ishte një gjë shumë e bukur. Është si një bari që ia jep delet e veta një bariu tjetër. Dhe kështu bëmë katekeza të Ecjes Neokatekumenale në të gjitha kishat klandestine. Por këta meshtarë ishin aq entuziastë, aq të lumtur me shpirtin tonë, saqë ajo e pëllumbit ishte vërtet një shenjë profetike për atë që po bëjmë për Kinën. Tani punojmë me Kishën zyrtare, fillojmë katekezat në katedralen e Pekinit dhe ata dëshirojnë të fillojnë edhe në dy famulli të tjera. Është një gjë shumë e bukur.

Po e përfundoj duke lexuar atë që kam shkruar për Ditarin e Carmen-it:

Vëllezër të dashur, për mua ka qenë prekëse dhe një surprizë e madhe të lexoja këto Ditarë të Carmen-it.

Etërit e shkretëtirës thonë: «Duaje Krishtin dhe mijëra do të të ndjekin». Dashuria për Krishtin që këta ditarë nxjerrin në pah është mbresëlënëse. Duket sikur Zoti Jezus i ka mbyllur të gjitha dyert përmes një vuajtjeje të thellë, që ajo të bashkohej vetëm me Të. Nga këtu vjen liria e skajshme e Carmen-it: asgjë e kësaj bote nuk i interesonte, vetëm dashuria për Krishtin. Është vërtet heroike që Carmen-i ka qenë me mua për pesëdhjetë vjet, gjithmonë duke vuajtur në heshtje, pa ia treguar askujt. Vetëm me Të. Një ditë thotë: «O Zot, duke mos dëshiruar më asgjë në këtë jetë, e varfër dhe pa asgjë, më lind dëshira e brendshme për praninë tënde të vetme. Shenjtëria, o Zot! Dëshira të fshehura për shenjtëri, për sakrificë, për ta mbushur ditën me praninë tënde, me lutje! O Zot, eja Ti t'i mbushësh gjërat me kuptim dhe mirësi. Forcoje fenë e Kiko-s». – Kjo është e mrekullueshme! Dhe unë ndonjëherë mendoja se ajo nuk më donte aspak! Asgjë nga këto nuk ishte e vërtetë. Tani kuptoj më mirë shumë fryte të

Ecjes. Hyji na dha një motër me një shkallë të veçantë shenjtërie. Dhe nuk mund të ishte ndryshe, duke pasur parasysh rëndësinë e misionit që Hyji na ka besuar. Duke lexuar dashurinë e saj për Krishtin, ndihem i vogël dhe i varfër dhe nuk di si ta falënderoj Hyjin që pata Carmen-in si shoqe në mision. Pesëdhjetë vjet pa asnjë çast pushimi: udhëtime, shqyrtime, vizita në shumë bashkësi, në Madrid, Zamora, Paris, Barcelonë, Romë, Firence, Ivrea... Duke dëgjuar dhe duke dëgjuar çdo vëlla për jetën e tij, vuajtjen e tij, historinë e tij, duke e ndriçuar atë në dritën e fesë, të kryqit të lavdishëm të Zotit tonë Jezus.

Mendoj se ju keni të drejtë të njihni zemrën e Carmen-it, dashurinë e saj të pamasë për Jezu Krishtin. Ajo thoshte vazhdimisht: «Hyj, të dua, të dua, eja, më ndihmo!».

Carmen-i ka shkruar Ditarët e saj për tridhjetë vjet, të cilët pak nga pak do t'i transkriptojmë, për të mirën shpirtërore të vëllezërve, të Ecjes dhe të Kishës. Kemi botuar tre vitet e para (nga 1979 deri në 1981), ku shihet puna e jashtëzakonshme e ungjillëzimit që kemi bërë. Ruajini këto shkrime me nderim. Askush prej nesh nuk e meriton një motër si ajo.

Lutuni për mua dhe për Carmen-in.

Kiko Argüello.»

Davide Cantagalli:

Ju falënderoj dhe, duke ju uruar një mbrëmje të mirë, ju kujtoj se libri gjendet për shitje pranë tavolinës që ndodhet në hyrje të sallës.

Ju kujtoj gjithashtu se të ardhurat që i takojnë autorit do t'u dhurohen familjeve të Ecjes Neokatekumenale në mision.

Kiko:

Le të bëjmë një lutje:

Të falënderojmë, o Zot, për këtë takim; të falënderojmë për Carmen-in dhe të përgjerohejmë për të, që ta mbash në lavdinë tënde me Ty. Të lutemi për Papën Françeskun, që t'i japësh shëndet, forcë profetike, ngushëllim në zemrën e tij dhe mbi të gjitha dhuratën e shoshitjes për të mbarështuar Kishën. Për të gjithë ne, o Zot, ki mëshirë!

Ati ynë

Bekimi